

VITI XV, NUMRI 11 / NENTOR 2011

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



*Drink More Aloe!*



# Gjeni Vizionin Tuaj

**N**jë herë pyetën Helen Keller, shkrimtaren e verbër amerikane, „Çfarë do të ishte më e keqe se sa të lindësh e verbër” pyetje të cilës ajo ju përgjigj: „Të shikosh pa patur aftësi vizioni”.

Kur mbyllni sytë, çfarë shikoni? Mund ta imagjinoni të keni jetën që dëshironi? Ku ndodhëni? Çfarë po bëni? Tridhjet e tre vjet më parë unë pata një vizion dhe ai vizion mu kthye në qëllim, pastaj në një mënyrë jetese, dhe faktikisht u bë realiteti im. Pa patur së pari vizionin se çfarë ishte e mundur, unë nuk do të isha këtu ku jam sot.

Shumë njerëz flasin për vizionin, por çdo të thotë në të vërtet vizion? Unë mendoj se vizioni është aftësia për të parë atë që nuk e shohin të tjerët, cilësia për të besuar tek ajo që të tjerët nuk besojnë dhe kurajua për të bërë atë që nuk mund ta bëjnë të tjerët. Vizioni na jep kurajon që të kërkojmë mundësitë që të tjerët do ti shikonin si të pamundura ose shumë të vështira dhe guximi për të marrë rrezikun që të tjerët e anashkalojnë nga frika e dështimit.

Unë mendoj se çdo arritje e madhe fillon me vizionin. Njerzit kanë nevojë për vizion që të motivohen për veprime që pa vizion do tu dukeshin të pamundura. Në qoftë se humbasim vizionin, ne humbasim fokusimin. Kështu ecim përpara kuturu, pa orientim dhe pa qëllim dhe kjo është më keq se sa të mos ecësh fare.

Shikoni nga e ardhmja, dhe kuptoni çfarë duhet të bëheni, çfarë doni të realizoni dhe çfarë jete dëshironi të bëni. Një mënyrë e veçantë, që vizioni juaj të jetë real, është krijimi i „Librit të ëndërrave”. Libri i ëndërrave ju detyron të krijoni shembuj konkretë për vizionin tuaj, për më shumë para, për një makinë, për një shtëpi, për arsimim, pra për gjithshka ju besoni se vizioni juaj do ti bëjë realitet. Libri i ëndërrave është një kujtesë e vazhdueshme se cili është vizioni juaj dhe një shëmbull real se çfarë mund të realizojë vizioni juaj. Ai ju motivon të ecni përpara edhe në momentet më të vështira.

Një gjë e rëndësishme për tu kujtuar për vizionin tuaj, është ajo që këtë vizion ta ndash bashkë me të tjerët. Si drejtues, kur ju i tregoni grupit tuaj dhe distributorëve të tu të mundshëm vizionin tuaj, në fakt ju u jepni atyre një hartë orintuese për vizionin e tyre. Me çdo person që ju lidhëni, vizioni juaj do të bëhet më i qartë dhe do tju shtyjë juve më përpara. Kur ju e ndani vizionin tuaj me të tjerët dhe punoni për ta bërë atë realitet, suksesi juaj do të jetë më i madh se sa e keni imagjinuar ndonjë herë.

Vizioni im për Foreverin nuk është lëkundur kurrë, sepse ju siguron njerzve mundësinë për një jetë më të shëndetshme dhe më të begatë. Kjo është po kaq e vërtetë dhe patjetër thelbësore edhe sot ashtu si në vitin 1978. Unë e kam ndarë vizionin tim me miliona njerëz në mbarë botën dhe jam krenar për çka kemi realizuar sëbashku. Unë e inkurajoj çdo njerin nga ju që të zhvillojë vizionin e vet, që të kombinojë objektivat personale me shpresat për biznes. Mos harroni, ju jeni të lirë të ndërtoni vizionin tuaj dhe të punoni për të ashtu siç doni bashkë me Foreverin. Ky është edhe thelbi i motos „Ji i lirë” që kemi për këtë vit. Pra synoni për më lart!

REX MAUGHAN  
I JUAJI PËR JETË







**D**alngadalë po afron fundi i vitit dhe po vjen momenti të falnderoj punën e gjithë atyre që vitin që po shkon më kanë ndihmuar aq shumë në punën time.

Më 30 nëntor 2011 mbaron mandati i Klubit të Presidentit; me këtë datë mbyllet një kapitull i tillë në historinë e Foreverit, që mund ta quajmë edhe kthesë e fatit.

Kudo që të shkojmë nëpër vende, drejtues firmash, investues të mëdhenj, ankohen dhe gjithkush flet vetëm për kushte ekonomike të vështira. Televizorin as që mund ta hapësh sepse atje vetëm ndikim negativ merr. Në këtë mjedis, ka një skuadër të tillë fantastike të Foreverit, anëtarët e Klubit të Presidentit, që duke u dhënë krahë forcave të veta, lënë pas një vit fantastik. Këto vënde të vogla, që përfshin rajoni ynë, nuk janë vendet më të pasura të botës. Megjithatë, i sigurtë mund të them se drejtuesit Forever që jetojnë në këtë rajon, janë më të mirët në botë, megjithse nuk jemi më të mëdhenjtë. Vënd i 6-të në botë dhe vëndi i 2-të në Europë si dhe fakti që gjatë 15 vjetëve që nga krijimi mbetemi ndërmjet 10 vendeve më të mira të botës, flet për qëndrueshmërinë tonë.

Komuniteti i drejtuesve fantastikë, me të cilët kam mundur të punoja gjatë këtij viti që po shkon, ndoshta një drejtor nuk ka marrë kaq ide dhe energjia të reja, sa kam marrë unë prej tyre në këtë periudhë.

Me këtë punë të përbashkët kemi mundur të ruajmë dhe përtërijmë vlerat tona dhe kemi hyrë në një periudhë të re të vrullshme të shitjeve në rajon. Përsëri skuadra jonë po fluturon në këtë mjedis që e permenda më lart, në një mjedis të tillë financiar, për arsye të të cilit edhe fincierë profesionistë deklarojnë dorëheqjen. Ne anëtarët e Foreverit përfaqsojmë ekonominë e vërtetë të shekullit 21.

Ndoshta ka nga ata që për herë të parë marrin në duart e tyre një katalog të tillë biznesi, atyre u jap mesazhin që të ardhmen e tyre e kanë në duart e veta, të kujdesen për të dhe Foreverin të mos e mendojnë si ato firma që lexojnë në kioskat e gazetave.

Bota rreth nesh po ndryshon shumë.

Foreveri dhe ne do të mbetemi për jetë një bazë e qëndrueshme, ne përfaqsojmë të ardhmen e sigurtë të fëmijve dhe prindërve të tyre dhe në qoftë ke besim tek vetja dhe këtë besim e projekton , se pse jen ë këtë botë, atëhere këtë mjet mos e lësho nga duart e tua.

Dëshiroj që edhe një herë të falnderoj anëtarët e Klubit të Presidentit, që sin ë jetë ekonomike ashtu edhe në jetën e tyre personale, edhe më tej të arrijnë suksese dhe i pres ata përsëri si anëtarë të këtij Klubi. Përpara FLP!



DR. SÁNDOR MILESZ  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



# Nga të gjithë Holiday Rally-it ky më i mirë



**N**ë një nga pikat më të bukura të Europës, në Porec të bregdetit dalmat u mblodhën 1200 vetë. Në vitin e tretë ishim kaq vetë; çdo shënjë tregon që diçka e madhe do të lëvizë në këtë rajon, në jetën e Foreverit. Gati 1000 vetë erdhën nga Hungaria, rreth 100 vetë nga Serbia, po kaq nga Kroacia, 50 vetë nga Sllovenia dhe rajone të tjera. Por këtu shfaqen edhe nivelet: më të mirët e një familje të madhe mbushin hotelet që na presin. Por shfaqen edhe nivelet midis diamantëve dhe supervizorëve. Këtu gjithkush mund të mësoj nga gjithsecili. Sivjet pak më ndryshe nga viti kaluar: paradite zhvillohen leksionet, ndërsa mbas dite programe të lira, sport e shetjtje që të kalitim edhe trupin tonë. Çlirimim nga ankthi e plotëson në mënyrë të veçantë firma. Në mbremje dy ditë para trainimit 2 ditor zhvillohet hedhja e themeleve, pikërisht aftësimi i diamantëve. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në botë; kualifikim ekskluzivisht për diamantët.

Si hyrje e tre ditëve, **Dr. Sonja Jovic** – menaxhere shtroi çështjen: kush është ai që dëshiron të jetë diamant? Leksioni i saj flet pikërisht për këtë, për vetëdijen. Sepse sikurse thotë ajo, vetëm ai mund të ndihmohet, ai që do. „ Si të keni mendimet tuaja, e tillë do të jetë edhe jeta juaj dhe kjo mund të ndikojë edhe në shëndetin tuaj. Mendimet negative kanë mundësi të shkaktojnë edhe dëmtrim të shëndetit, sepse truri përmes hormoneve komunikon me trupin tonë. Sinjalet për sëmundje të japin mesazhin se duhet të ndryshosh. Lajm i mirë është ai që nuk ka sëmundje të pashërueshme, por vetëm njeri të pashërueshëm”. Sikurse thekson Dr Jovic, shëndeti njëherashi do të thotë mirëqënie psikik, fizik apo social. „Vendimi është në dorën tënde”- thekson ajo në fjalën që nisi këtë trainim, dhe prej kësaj aktivitetet përshpejtohen.

Vjen **Kati Gidófalvi**, një nga ndërtuesit më të shpejtë në botë të nivelit diamant, një nga mbajtëset e këtij rekordi bashkë me bashkëshortin e saj. Na lehtëson nga diçka” nuk është problem , në se nuk do të behemi të gjithë diamantë” – thotë ajo, Por lehtësira të tjera nuk na jep, „tani, thotë ajo, duhet të duhet të luftojmë shumë që ti shohim gjërat pozitivisht. Sekret i suksesit është skuadra- dhe me këtë Kati nuk nënkupton vetëm skuadrën e biznesit, - por edhe objektiva dhe punë e koordinuar edhe brenda familjes. „ Mardhëniet me njerzit janë më të rëndësishmet, duhet dhënë shëmbulli personal në çdo arritje niveli. Për këtë duhet gjetur njerzit e duhur, në radhë të parë do të duhet ta bëje vetë. Mzndet që gjatë ecjes përpara të është dashur të mesosh shumë, por me mbështetjen e njeri tjetrit jo





**GJITHMONË I NGJASHËM DHE ÇDO VIT PAK MË NDRYSHE: KËTË PËRSHTYPJE TË JEP PORECI, QËNDRA E „AFTËSIMIT TË MENAXHERËVE. NË FILLIM TË VJESHTËS KËTU MBLIDHEN SË BASHKU TALENTET MË PREMTUESE TË FOREVER LIVING PRODUCTS NGA HUNGARIA DHE RAJONI, QË TË MËSOJNË, TË MËSOJNË NGA MË TË MËDHENJTË, DHE TË MARRIN GJITHSHKA SI NGA ANA PRAKTIKE ASHTU EDHE NGA ANA SHPIRTËRORE, QË ËSHTË E NEVOJSHME PËR SUKSESIN.**

bëhet edhe më e lehtë. Gjej mënyrën e ndërtimit të biznesit, që i përshtatet më mirë personalitetit tënd dhe atëherë do të lidhen me ty- na siguron Kati e cila tregon atë që vitet ja kanë mësuar. „Punën nuk e bën për FLLP-në por për veten tënde, thotë ajo, dhe megjithë efektiviteti varet nga ne, jo gjithmonë e jep rezultatin menjëherë. Prandaj ka rëndësi angazhimi dhe që të kërkosh njerëz të tillë që kanë krijuar vlera për tu marrë shembull”.

Pas diamantes më të shpejtë vjen diamantja më e parë: **Vera Lomjanski**, udhërrëfyesja e Evropës Lindore, e cila sipas **Dr Sándor Milesz**, se bashku me të shoqin ndërtoi rrjetin plotë me ndjenja e dashuri. Dhe Veronika përmend pikërisht faktorët shpirtërorë, tëlla që mund të percaktojnë fatin e biznesit: vetëbesim, aftësi për të kërkuar falje, përgjegjësi ndaj punës, ndaj familjes dhe ndaj bashkëpunëtorëve. Prandaj dhe jemi diamantë- thotë ajo. Në kuptimin e saj, në se do të jemi diamantë varet pikërisht nga qëndrimi ynë. „A je bindur sa forca ke? Veprimet negative si ankesat, justifikimet, dyshimet në ndërgjegje, vetkeqardhja, mungesa e talentit ta heqin forcën. Kështu që hapi i parë është që të njohësh gabimet e tua. Unë kurrë nuk kam bërë fajtor tjetrin për gjërat që kanë ndodhur në biznesin tim dhe tashmë punoj me menaxherët më të mirë në botë.”

Dikur edhe lektori që pason ishte një nga menaxherët më të mirë, kurse sot nga shumë pikpamje është një nga më të mirët në botë. Dr Sándor Milesz thekson: gjatë gjithë jetës së tij ka ecur vetëm përpara „, ky është Miki ynë, të cilin vetëm mund ta duash”. Sipas Miklós Berkics njeriun nuk e bën diamanti, por mendimet: kush je ti, kush do të mund të ishte, a të duhet fitimi profit share, atë duhet rruga e New York-ut ...” dhe që kanë kuptim si të thuash: a do të fitosh para, të kesh diamante – ashtu sikurse e thotë lektori dhe sikurse është formuluar parrulla: going global. Miklosi këtë e quan ndërkomtarizim, mbasi sikurse thotë ai, nuk lejohet që të mendosh si i vogël: „kudo mund të jesh yll botë”. Ndale ti mësosh gjuhën, ndryshe këtu mbetesh „brënda guaskës”, dhe prej saj nuk sheh gjë. Por ka jetë edhe jashtë guaskës tënde! Çështja është vetëm , a ke edhe ti endërra, a e do edhe ti fitimin!”. Në vend të tretë në një sport masiv, kështu e quan Miklosi, kur dikush nuk i përvishet megjithë zemër punës. „Mund të jesh milioner me dollarë dhe me diamante, sepse ky biznes është i yti. por në qoftë se nuk i ke mbushur qindpërqind qelizat e trurit tënd, mos llogarit rezultate mahnitse!”

Me këtë thënie provokuese shkojmë të flemë dhe me ato synime të palëkundura që nesër qelizat tona të trurit të freskët do të koncentrohen në podium me gjithsecilin. Ndërkohë sigurisht pas nesh shikojmë koktejin e nuancave të shkëmbinjve të bregut dalmat, të rërës, të detit të kthjellët dhe të lagunës së gjelbër, ndjenjën e llusit të vetë pishinës, darkën e bollshme, dhomat e klasit të parë, mbasi mikpritja e Forever Living Products dhe e zyrës së saj në Kroacia është e njohur.

Gjërat më të rëndësishme nuk ndryshojnë: në sallën e sporteve të Porecit programi nis me tingujt e hymnit. Grupin ndërkomtar e pret kënga e **Lajos Túri**, senior menaxherit Lui, pastaj **Jadranka Kraljic Pavletic**- senior menaxhere dhe **Tibor Lopicz** - soaring menaxher, të dy anëtarë të Klubit të Presidentit përshëndetin pjesmarrësit „në një nga trainimet e drejtuesve më të mëdhenj të Europës dhe të botës” ku personalitetet më të njohura të firmës japin njohuritë jo vetëm të kuptueshme, por që edhe mund të ndahen me të tjerët, që mund ti çojnë në vendet e tyre, që mund të përjetohen dhe shfrytëzohen. „Qëllimi është që kushdo po të mundet të ngjitet edhe më lartë, qoftë edhe brënda këtij viti.” - nënvizon Tibor Lopicz, pastaj përshëndeten të ardhurit





nga Serbia, Kroacia, Bosnja hercegovina, Sllovenia, Kosova, mali i Zi, Shqipëria dhe Hungaria si dhe drejtuesin e gjithë skuadrës, drejtuesin me medalje bronxi të Europës Dr Sándor Milesz, i cili 6 vjetë më parë e ëndërroi këtë takim që e ka zili gjithë bota. Dr. Milesz , së pari përshëndet anëtarët e Klubit të presidentit, motorrin, pa të cilin e gjithë kjo nuk do të funksiononte, pastaj falnderon drejtorët rajonalë për punën e tyre. „Punojmë me një skuadër të vogël por me forca të mëdha” – shprehet ai. „Tre gurët e themelit të MLM janë njerzit e thjeshtë, njohuritë dhe gatishmëria për komunikim. Të tria mund ti zhvillojmë, prandaj dhe kemi ardhur këtu, për më tepër me rrjetndërtuesit më të mirë të botës.” Ndërsa gurët më të rëndësishëm të ndërtimit të rrjeteve janë të kualifikuarit: „ju jeni pamja e ardhshme e Foreverit. Përvoja jonë është që 30% e supervizorëve arrijnë menaxherë, por ne do të donim që 100% të jenë bashkpunëtorë të sukseshëm, të lumtur dhe të shëndetshëm. Ju do ta çoni FLP e Hungarisë dhe të gjithë rajonit në vëndin e parë në botë.” i mbyll mendimet e veta Dr Sándor Milesz duke hapur serinë e programeve zyrtare”

Aloe Barbadensis Miller apo Aloe mjekësore sikurse kushdo në këtë sall e di përse bëhet fjalë. Flitet për atë që e kanë përdorur Nefertiti, e Kleopatra, grekët e lashtë, Hippokrates, Aleksandri i madh dhe Aristoteli, Kristofor Kolombi por edhe Paracelsus, fiset hindu e maja, samurajet japonezë dhe mjekët kinezë për tu mjekuar e për të mjekuar me të. **Dr Edit Revész Siklósné**, soaring menaxhere dhe mjekë konsulente, gjithkëtë e mbështet me rezultatet shkencore moderne për efektet e kësaj bime në ruajtjen e shëndetit. Me efekte kundër mikrobeve, paksuese e inflamacioneve, qetsuese e dhimbjeve, mjekuese e plagëve...me 240 lëndë të efektshme, të vërtetuara nga pikpamja mjekësore si vitamina, acid folik, aminoacide, nje varg enzimesh përbëjnë paletën e çuditshme të kësaj bime. „Aloe është e mirë për gjithshka ti e do, si mbrojtëse e shëndetit, si bimë medicinale, si mjet për suksesin në biznes, mundësi për kujdes ndaj të tjerëve” - thotë Dr Edita, falë kësaj bime ne mund të jetojmë shumë më të shëndetshëm.

Për përvojën e produkteve na bind edhe kirurgu **Dr Endre Seres**, mjek i sporteve, që jep leksionin e tij edhe si zafir menaxher. Gjatë viteve nga një skeptik u bë një ndëtuës i përkushtuar rrjetesh. Sipas Dr Endre, suksesi vjen nga kujdesi i vashdueshëm dhe i zellshëm ndaj klientëve, durimi dhe njohja e produkteve. „Unë tashmë e di sekretin – thotë zafir menaxheri. Misioni ynë është që rreth nesh të bëjmë sa më shumë njerëz të të shëndetshëm dhe të lumtur. Forca e Foreverit na e jep këtë mundësi, ua jep edhe juve. Kin ipara sysh një vizion, se sa njerëz mund të zini për dore dhe mos ndaloni deri sa të arrini nivelin e menaxherit.”

Pas tij vjen një tjetër mjekë konsulente, që krahas titullit soaring menaxhere është edhe shtatë herë fituese e profit sharing, nëntë herë anëtare e Klubit të Presidentit: ajo është **Dr Terézia Samu**. Prej saj dëgjojmë pse kemi nevojë për një ushqyerje të ekuilibruar. Përmbajtja e lëndëve ushqyese të frutave dhe zrazavateve po ulet me shpejtësi, ndërsa mungesa e vitaminave dhe elementëve të gjurmës apo mineraleve të rralla në organizmin tonë shkaktojnë mosfunksionim të organeve dhe për rrjedhim sëmundje. Në Hungari çregullimet e zemrës dhe të qarkullimit të gjakut janë më të mëdha, dhe në çdo dy vetë njërin e humbasim nga këto shkaqe. Doktoresha hedh poshtë atë mendim të gabuar që





shumë vitamina mund të bëhen të dëmshme, dhe krahas kësaj tërheq vëmendjen për lëvizjen, për jetën e planifikuar e të rregullt, dhe për rolin e saj në mbrojtjen e pastërtisë mendore të familjes dhe të miqve. „Bëje jo për atë, pse duhet por për atë pse të dua” – kjo është motoja.

Pjesën e mëtejshme të bllokut të mjekëve e drejtojnë soaring menaxherët **Dr Ilona Juronics Vargáné dhe Dr Endre Németh**.

Pas kërcimtarëve të grupit Latin në podium ngjitet **Tibor Éliás** dhe prej këtej sheshi bëhet serioz. Ajo që i intereson gjithkujt, si mund ti shtosh në maksimum pikët? Vetëm atëhere mund të jesh i sukseshëm nqse produktet i përdor edhe vetë , në qoftë se investon shumë punë dhe mban qëndrimin e duhur.” – thotë Tibor, sipas të cilit në rastin e dhënë më e rëndësishme se pikët është një njeri i kënaqur sepse ai mund të sjellë një mijë të tjerë. „Jepu informacion korrekt dhe të ndershëm me bindje të brëndshme dhe gjithmonë duke buzëqeshur. Pikët do të vinë nga njohuritë e tua, nga ajo që nga askush të mos heqësh dorë. Jepi mundësi, sepse nuk mund ta dish kush do të jetë ai nesër. Mos puno për vete, por për të tjerët, për skuadrën, për familjen, për sponsorin tënd. Unë e bëj për atë, sepse nuk dua të jem mediokr. Ndezu, hapi krahët, fluturo! I ke të gjitha mundësitë për sigurimin e parave dhe të suksesit, përmes njeriu pas njeriu mund të pershkosh gjithë botë. Përkushtoj me gjithshka, ndryshe nuk ja vlen!”

Si e organizoj punën e ka titullin leksioni i **Zsolt Fekete** – zafir menaxher, por ndoshta nuk ka gjë për të thënë sepse këtu në këtë sallë ndodhen më të mirët, mbasi në takimin e Porecit kanë ardhur 1200 vetë, prandaj edhe biseda zhvillohet si e zakonshme, sin ë vaj. Këtë lehtësi duhet ta përcjellim edhe në vendet tona – duke nisur nga familja. „Bisedoni, çdo të thotë në jetën tuaj nqse i përvisheni kësaj sepse edhe familja është një skuader” – tërheq vëmendjen Zsolt, pastaj vazhdon analogjia: shko në stërvitje, dëgjoje trainerin tënd, domethënë sponsorin tënd dhe sakrifiko. përjetoje atmosferën dhe krijo atmosferën e duhur. Qëllimi final nuk është Olimpi, por një ecje e ngjashme me këtë duke ngjitur nivelet njeri pas tjetrit.

Dhe për këtë jemi në skuadrën më të mirë, për këtë na siguron **István Halmi**. „Pse duhet të punojmë me skuadër – shtron pyetjen ai. Tamam ashtu si patat e egra që fluturojnë edhe 70% më larg kur fluturojnë bashkë. Duhet të bindësh bashkshortin, burrin apo gruan tënde, kjo është me rëndësi kyçe. Në çdo skuadër ka rregulla loje. Pyetja shtrohet, a mund të përshtatesh me normat? Bëj bilancin , për çfarë mundesh, dhe mos ki turp të kërkosh ndihmë për çka nuk mundesh. Në një skuadër të mirë mund ti drejtohesh gjithkujt, dhe do të ndihmojnë. Por loja në skuadër është e vlefshme reciprokisht.”

Kur, Pse, dhe Si: këto tre pyetje shtron menaxheri **Balázs Bársony**. Por lajmi i mirë është që këtu nuk mund të mbështetemi vetëm në mjetet tona: në këtë potencial kontribuon çdo bashkpunëtor i yni. Nga Balázs dëgjojmë jo vetëm teori por edhe veprime praktike, si të bëhen listat, si të frohen njerzit, si të bëhet prezantimi i produkteve. Shumë përlothen nga videoja e shfaqur prej tij, në të cilën sportisti amator Lewis Pugh noton përmes akujve në ujën e ftohtë -1 gradë, që të rrënjosë besimin dhe rrit rezistencën. „Tash këtu gjithshka është në rregull, por kur shkon në shtëpi do të ndjesh ujën e ftohtë. Duhet ndeshur me sfidat, ta kesh të fiksuar në kokë, se mund të rezistosh edhe atëhere kur të tjerët nuk besojnë. Mund ta bësh!” - me duartrokkitje të fuqishme përcillet lektorin që tani debuton. Krahas punës së tij 12 orëshe e filloi ndërtimin e rrjeteve senior menaxheri **Ádám Nagy**, i cili tani prej 6 vjetësh merret vetëm me këtë punë. Atë e tërhoqi „rezultati i trashëgueshëm”. „Bën atë që do,








merresh me atë dhe atje ku do; ky është biznesi i lirisë” – thotë Ádám, sipas të cilit ky biznes të siguron jo vetëm para dhe kohë të lirë, por edhe qetësi, njohje të gjuhëve, zhvillim personaliteti, mënyrë të re të menduarit, shoqëri. Dhe se si shëmbulli i sipërmarrjes private të familjes amerikane mund të bëhet e natyrshme edhe këtu tek ne, këtë e tregon historia e familjeve tona. Ádám tregon për fate të tilla në Forever, ku fëmijët arrijnë rezultate të shkëlqyera në sferat e tyre. Kjo do të thotë sinergji, bashkim forcash. Por duhet edhe pak frymëzim, lëshim dhe tolerancë – dhe skicohet rruga për tek diamanti.


Një biznes të tillë me shumë gjenerata ka edhe menaxherja diamant zafir **Aranka Vágási**. Sportistja dhe mamaja që punon prej 13 vjetësh, sipas pohimit të virtuteve të veta: dhembshuri, forcë dhe pëlqimi i sfidave. –Kërko nga ata që për diçka kuptojnë shumë – këshillon ajo,- dhe „shfrytëzo” gjithkënd për atë që ja vlen. Unë kështu e shikoj çdo kandidaturë, sikur ai është diamanti im. Nuk ka gjë edhe në qoftë se ai nuk arrin, nuk ka gjë edhe në qoftë se të duhet ta presësh disa vjet!

Aranka na prezanton menaxherin e 21 të saj: **Erika dhe Harry Davis**. „Të qëndrosh këtu është shumë mirë, të jesh menaxher është një gjë shumë e mirë. Në qoftë se ne mundëm ta bënim, kushdo mund ta bëjë” - thonë eksploratorët.

Që nga fillimi i programit në skenë qëndron një pasqyrë e madhe dhe një mbajtëse qirinsh shumëdegëshe. Tani e kuptojmë pse. Pason leksioni që i përshtatet performancës të zafir menaxherit **József Szábó**. Të ndikon jo vetëm në mendim, në ndjenja por edhe në hov. Themeluesi i FLP i nxit të gjithë që të kthehen mbrapa në kohë, të shikohen para pasqyrës dhe pastaj herë pas here të veprojnë







në këtë mënyrë. ”Unë doja të isha diçka krejt tjetër, nga ç’isha deri atëhere- pohon Józsi – dhe duhej dikush, që besonte se isha i aftë për më shumë se sa mendoja për veten. Nuk është kurrë vonë të gjesh, por do të duhet të ndryshosh. Pasqyra po kështu premton, vetëm premton dhe të gënjën gjithë jetën. Por në qoftë se e bën mirë, gjithnjë e më pak.” „Dhe kur fjalët e József Szabó shuhen në sallë, qirinjtë ndizen e shuhen. Një mbetet deri në fund „Këtë biznes e kanë shkruar me nder dhe respekt. Do të duhet të jesh i qëndrueshëm, rezistent dhe konseguent. Puno dhe ndonjëherë shikoju në pasqyrë.”

**Attila Gidófalvi** tashmë është duke punuar nëpër Europë për të arritur rezultate të reja, ndërkohë bashkëshortja e tij **Kati** mban leksion në podiumin e Porecit. Ajo tregon për fillimin, se si morëren shpejt ndihmën nga drejtuesit gjatë hyjes në Forever. „Kërkoja garancira dhe dhe këtë ma garantuan produktet – thotë Kati, pastaj nënvizon atë që të gjithë e marrim me mend: por në pjesën e biznesit jemi vërtet të mirë. „Biznesi është rezultat i personalitetit. Kur kemi punë, gjithshka e lëmë mënjanë në qoftë se kemi qëllim udhëtimi në Rusi, në Azerbaixhan apo Kazakistan. Nuk dua thjeshtë punën, por atë që të vendos e lirë, dhe të bëj atë që edhe më argëton e frymëzon. Edhi biznesi i një diamanti mund të jetë si një masë preventive për jetën e gjatë, të lumtur dhe të shëndetshme. Kjo jetë as për Katin nuk ka nisur e lehtë: i është dashur që të lërë pas përvojën e 17 vjetëve. „Vetëm se donim më shumë, dhe kjo çudi mrekulli mund të ndodhë edhe me ju. Nuk ka rëndësi se ku ke lindur, gjithshka varet nga ajo „fiksoje në kokë” çfarë jete do të bësh. Kati flet për sendet, për gjëndjen materiale. Nuk dua të mburremshprehet ajo- „vetëm se dua ta shikoni, se çfarë jete mund të bëni”. Ditën e parë të Porecit, por edhe paraditen e mbylli leksioni i Katit sepse pas një dreke të vonuarnë program kishim një shetitje me anije, me tango me firzamonikë, me rakinë vendase, me perëndimin e diellit në det. Dhe mbasi tretëm mirë drekën, na priste përsëri një darkë në një tavolinë të madhe të shijshme. Vetëm pak vetë ranë herët në krevet, sepse thuajse për gjithkënd më e rëndësishme se gjumi ishte të bisedonin lirshëm, të miqësoheshin me kolegët e tyre.

*Përshtypjet e Holiday Rally-it do ti vazhdojmë në numrin e ardhshëm të revistës sonë në Dhjetor*





# Falenderime FLP-s, sipërmarrjes më të mirë në botë!

**O**rganizimi Holyday Rally-t në Poreç këtë herë qëndronte më lart se çdo herë tjetër. Të gjithë Rally-t e deri tanishëm kanë qënë të veçantë, por ky ishte i magjishëm. Falenderime drejtorit të përgjithshëm të FLP-s, Dr. Sándor Mílesz – ideatorit të Holyday Rally-t të Poreçit – për organizimin me nivel, sepse në këtë eveniment trajnojmë më tej distributorët tanë, me këtë bëhet e mundur zhvillimi i FLP-s, kjo siguron ekzistencën tonë, dhe të ardhmen tonë më me efektivitet.

Falenderime edhe grupit të menaxherëve: FLP-ja e Serbisë - Branislav Rajić, FLP-ja e Bosnias – dr. Slavko Paleksić, FLP-ja e Kroacisë – dr. László Molnár, FLP-ja e Sllovenisë – Andrej Kepe. Ju falenderojmë për ndihmën që ju keni dhënë bashkpunorëve tanë, me qëndrimin tuaj. M.q.s. tashmë që prej trembëdhjet vjetësh kam qënë e pranishme në shumë Rally të organizuara nga Rex-i, mund të deklaroj, se organizimi juaj si dhe marrëdhëniet tuaja me të kualifikuarit dhe distributorët e tjerë dha të njëjtin motivim si në Rally-t e Amerikës. Kësaj i bashkangjiten edhe seminarët e diamantëve. Ata bënë të pamundurën, që të inspirojnë pjesëmarrësit e Rally-t për atë që të mos dorëzohen kurrë. Treguan edhe rrugën që të çon drejt kualifikimit si diamant. Është e kuptueshme n.q.s. do të thosha, që kjo është si kremi në tortë. U takova me shumë menaxherë, të cilët prandaj kishin ardhur në Poreç, sepse e dinin, që këtu është vendi i tyre! E dinë, që vetëm n.q.s. marrin pjesë në të gjitha takimet e FLP-s, mund të sigurojnë zhvillimin e tyre. Jam e lumtur, që nga disa rajone erdhën shumë të kualifikuar për arritjen trainim. Në sytë e tyre lexova dëshirën për mësim, ndjeva brenda tyre energjinë, e cila do ti shtyjë ata për arritjen e rezultateve të mëdha. Ishin të vëmendshëm, dhe mbajtën shënime të gjitha fjalët nga leksionet e mrekullueshme dhe mësimdhënëse të lektorëve më të mirë. Falenderime për ju, lektorë! Jeni profesionist dhe specialist të vërtetë në menaxhim. Falë jush shumë bashkpunorë të ardhur nga gjithë rajonet u pasuruan me shumë njohuri të reja. Tani radha është për ata, që me ndjenjë përgjegjësie të përdorin mësimet e marra, dhe të ecin më shpejt përpara. Besoj tek ata – ashtu si dhe në vetvete – dhe në atë, që edhe ata do të dëshironin të ecnin më përpara, pa pretekste. E ndjej, se rajoni ynë nga energjia e ndezur, në 2012 do të sigurojë vendin e tretë në botë dhe të parin në Europë, sepse vetëm me përkushtim dhe bëma të përbashkëta mund të arrijmë në kulm. Falenderojmë zyrën e Kroacisë për punën profesionale të bërë në fushën e organizimit të Holiday Rally-t, këtu do të jemi edhe në të ardhmen, me më shumë bashkpunorë të kualifikuar.

Falenderojmë edhe anëtarët e Klubit të Presidentit për mendimet e shkëlqyera. Ju jeni më të mirët!  
Falenderime mirënjohëse për të gjithë!

**Veronika dhe Stevan Lomjanski**  
**Diamant menaxherë**  
**dhe anëtarë të Klubit**  
**të Presidentit nga FLP e Serbisë**





Ne superskuadra „Çdo muaj 100 – DREJT TOP 20 NË FLP!” zotohemi se tregun hungarez do ta riklasifikojmë! Ne jemi ata, që marrim përsipër, që duke përdorur ciklin e FLP-s, të shpërndajmë informacion drejt 100 lidhjeve (telefonatave) në çdo muaj nga qershori 2011, duke u përpjekur, që prej kësaj të dalin 5 bashkëpunorë të rinjë dhe të shtojmë çdo muaj kapitalin e marrdhënieve me 50 emra të rinjë! Këtë duke e përfunduar me vendosmëri do kemi gjithnjë e më shumë bashkëpunorë, ku pikët jo-menaxheriale të cilëve të arrijnë çdo muaj 100 pikë, duke u futur me këtë mes më të mirëve të Foreverit! Pas trajnimit në Poreç të gjithë mbrritëm në Hungari me një atmosferë shumë të mirë dhe me plane të mëdha, të mbushur me këto ndjenja lindën zotimet e drejtuesve të supergrupit:

## Zotohem, që...

“...do të përkrah dhe ndihmoj grupin tim me të gjithë forcën dhe njohurit e mia, që mes tyre të ketë sa më shumë në 20 më të mirët e Forever-it të Hungarisë! Pamvarësisht nga vështirësit mbetem besnike e betuar e Forever-it dhe me punën time do çoj më tej iden e firmës „pastër dhe thjesht”!

Deri në 31 dhjetor 2012 do të realizoj programin promovues për Profit Sharing, ndërsa në 30 nëntor 2016 do të jem soaring manager! Ky rezultat bën të mundur, që pas kësaj të shkoj për një vit për pelegrinazh indian, ndërsa në 50 vjetët në vazhdim do të doja të bëja, atë që kam dashur gjithmonë: të merrem me fëmijët! Të udhëheq fëmijët jetimë ose në vështirësi drejt një jete më të mirë.”

**Judit Molnár senior menaxhere**



“...do të jetoj me një vetkontroll të madh dhe përpikmëri me orarin. Do zgjohem herët në mëngjes dhe pas trajnimit trupor, dhjetë minuta do jem me veten, që të dëgjoj zërat e shpirtit. Do ti lë ata njerëz dhe ato punë, të cilat më dhanë mjaft në jetë. Jo me mërzitje, por me mirënjohje në zemër do të shkoj më tej. Do ta deklaroj çka është e mirë dhe nuk do të merrm me atë që nuk të çon përpara. Që sot do të rregjistrohem të mësoj anglisht. Sigurisht këtu janë edhe punët e përditshme, do bëj punën time, por do dëgjoj zërin e brendshëm dhe menjëherë e di, që kur duhet të ndaloj dhe kur duhet të hedh një hap më tej. Kështu do ti gjej shumë më shpejt ata pesë bashkëpunorët e rinjë, me të cilët do të ndërtoj më të ardhmen e bukur, një të ardhme më të bukur se kjo për ata dhe për veten tonë. Deri në 28 qershor 2012 do të realizoj nivelin e parë të programit për makinën. Besoj, që jam e aftë për çdo gjë dhe e di, që ai që përparon në rrugë me besim, atij ja drejton rrugën Zoti. Faleminderit për mundësinë.”

**Mónika Szolnoki menaxhere**



“në tetor 2009 isha për herë të parë në Poreç, në “inkubatorin e menaxherëve”. Aty vendosa të jem menaxhere, dhe u bëra. Tani përsëri lindën shumë-shumë zotime. Supervizorët vendosën, që të bëhen menaxherë. Edhe unë mora disa vendime në këtë takim. Vendosa, që në të ardhmen të jetoj më me vetdije dhe vetkontroll se deri tani, të rifreskoj dhe të zhvilloj më tej njohurit e gjuhës. Mesazhin e Rex-it do ta transmetoj tek më shumë njerëz dhe do të bëhem njeri i tillë, i cili pas disa vjetësh si anëtar i Klubit të Presidentit të kem efekt pozitiv në jetën e shumë njerëzve dhe familjeve. Falenderoj të gjithë organizatorët dhe lektorët, që me punën e tyre ndihmuan në zhvillimin tonë, në rritjen tonë morale dhe materiale.”

**Dr. Boglárka Francia menaxhere**



“... János Mikó-t dhe Noémi Kiss Mikóné-t në mesnatën e 19 marsit 2012 në orën 00.01 ose do ti “coptoj” pse nuk e kanë mbajtur premtimin, ose do ti “coptoj”, pse e kanë mbajtur, çfarë premtuan. Duket sikur është njësoj, çfarë do të bëjnë, do ta marrin – vetëm se njëri nga inati, tjetri nga gëzimi im! Premtoj, që në këtë ditë, 19 mars 2012 me bashkëshortin do të jemi senior menaxherë.”

**Erika Szántó & László Gyurján asistent menaxherë**



Ne zotuesit, në emrin tonë dhe të të gjithë antarëve të grupit tonë i falenderojmë drejtuesit, - me të cilët ky biznes na lidh përjetë – për të gjitha, për të gjitha ato që mundëm të mësonim prej tyre, dhe për atë, që edhe më tej sheshojnë rrugën tonë dhe na ndihmojnë në realizimin e zotimeve! Me emra: Teca Herman, linja jonë e sipërme, që është për ne një shembull i vërtetë si grua dhe si drejtuese, Ilona Orosz dhe Dr. Zsolt Gönci, sponsorët e mi, të cilët jo vetëm më futën në këtë biznes, por mund ti llogarisim ata për çdo gjë në çdo moment në këto vitet e fundit! Së fundi Csaba Juhász, i cili në periudhën e fundit prej një viti e gjysëm, si trajner i preferuar i skuadrës, i dha forca dhe entuziazëm të ri zhvillimit të grupit, dhe duke u bazuar në qëllimin e vënë u krijua grupi „ÇDO MUJ 100 ☺ - DREJT TOP 20 NË FLP!”







# SUCCESS

BUDAPEST 22.10.2011

Day

**S**humicës prej nesh i kujtohet, kur **Anita dhe Zsolt Leveleki** me rastin e klasifikimit soaring menaxher qëndronin në podium, ndonse nuk dukeshin shumë nga pylli i luleve. Sot po atje i shikojmë ata si drejtues të programit - edhe ky rol ju shkon shumë mirë atyre. "Kjo është një ditë e veçantë, sepse jeni njerëz të veçantë - fillon Anita - jo vetëm mendoni për një jetë më të mirë, por edhe veproni për atë!"

Çifti fton në skenë drejtorin e përgjithshëm **Dr. Sándor Miliesz**, i cili në radhë të parë përshëndet ata, të cilët "tashmë kanë vënë diçka në tavolinë" dhe me të drejtë u shndrruan në menaxherë apo drejtues menaxherë. Shprehu respekt edhe për antarët e President's Club.

"E mirë është medalja e bronzit, por nuk është e vërteta!-dëgjojmë nga drejtori i përgjithshëm, i cili tashmë e ka skicuar shumë herë atë plan, sipas të cilit Forever-i hungarez duhet të jetë i pari në botë." Nuk duhet shumë më të mirë-thotë-sepse edhe tani jemi të mirë, por vetëm më të mëdhenj."

Dr. Sándor Miliesz fton **dr. Edit Révész Siklósné**, e cila ka mbajtur një fjalim në kongresin botëror të mjekëve.





NDRYSHIMI ISHTE IDEA E RIKTHYER NË DITËN E SUKSESIT TË TETORIT; SIKUR ÇDO LEKSION TË ISHTE NJË ARGUMENT KRAHAS ASAJ, PËRSE DUHET SHKËPUTUR NGA NJË MËNYRË JETESE, N.Q.S. NUK E NDJEJMË ME TË VËRTETË TË TONËN. PËRSE DUHET TË MARRIM VENDIMIN DHE TË SHNDRROHEMI NË NDËRTUES TË RRJETIT. NËSE PËR TJETËR GJË JO, ATËHERE ME SIGURI, QË SË SHPEJTI EDHE NE TË JEMI ANTARË TË GRUPIT NUMËR NJË NË BOTË.

Ky është një vlerësim i madh jo vetëm për atë, por edhe për vetë FLP-n e Hungarisë.

Mysafirët e shpesh të tashmë e kanë mësuar, që pothuaj në çdo Ditë Suksesi kontribuojmë për ndonjë qëllim. Këtë herë do të ndihmojmë me dhurim produktesh në shërimin e një vajze 12-vjeçare nga Kisvárdá që bëri transplantim zemre, të cilat tani për familjen janë më të rëndësishme se paratë.

Tani ka edhe mënyrë tjetër për tu dalluar nga të tjerët: ai ka rezultat të mirë, mund të firmosi flamurin e Forever-it, i cili do të valvitet në Rally-n European që po afron. "Jeni dakort që të punojmë për vendin e parë? - pzet përsëri Dr. Sándor Mílesz, por në një farë mënyre edhe përgjigjet: "duhet ta bëjmë, se jemi në gjendje! Kemi drejtuesit më të mirë, dhe punojmë së bashku me shtetet më të mira."

Gjithmonë midis lektorëve të Ditës së Suksestit ka shumë të tillë, të cilët me ndërtimin e rrjetit lanë mënjanë atë mënyrë jetese që ishte e shoqëruar me shumë punë, me stres dhe me mundim. Një dhjetvjeçar më parë as **Dr. Ibolya Bagoly** nuk ishte bërë senior menaxher shpeshherë gjatë gjithë ditëve ishte mjek roje, dhe fëmija







i vogël e shihet vetëm të lodhur. Por sot thotë: "ji egoist, sepse nëse ti nuk je i shëndetshëm, nuk mund të ndihmosh edhe të tjerët. Nga leksioni i Ibolya-s rezultojnë se roli gjenetik dhe ndikimi i mjedisit është shumë më i vogël se mënyra e jetesës. Tema e sotme do të jetë për një faktor tjetër të rëndësishëm krahas lëvizjesh: ushqimi - i cili ka kuptim më të gjerë se thjesht e ngrëna. "Organizmi jonë ka nevojë për të gjithë kubat ndërtues, ashtu si alfabeti për të gjithë gërmat - shpjegon mjekja, duke vënë theksin tek roli i ushqimit të ekuilibruar, të shumëllojshëm dhe vitaminat. Menjëherë mësojmë edhe atë, çfarë ndodh, nëse do të prishet ekuilibri, sa shumë probleme shkakton mungesa e vitaminave, si dhe përse sistemi imunitar ka nevojë tre-pesë herë në ditë për perime dhe fruta, por bëhet fjalë edhe për hudhrën, propolisin, aloe verën nga farmacia natyrore." Është përgjegjësia jonë, që trupi ynë pas disa vitesh do të jetë apo jo i shëndetshëm" - thotë Ibolya, më pas vijonë klasifikimet: mund të gëzojnë supervisorët dhe assistant menaxherët.

Para klasifikimeve ra fjala edhe për ndryshim fati, **János Tóth** senior menaxher për të qënë i pavarur dorëzoi jo ekzistencën si nëpunës por si sipërmarrës. Jo me gjaknxehtësi, por thjesht duke bërë bilancin e përparësive dhe të metave. Sepse këtu me 3-4 orë punë arriti të njëjtin rezultat, si në sipërmarrjen tradicionale me 8-10 orë punë, ndërkohë që këtu nuk shpenzon për të punësuar (krahas asaj, që këtu nuk ka nevojë për investim kapital). Nuk je i lidhur me zyrën - mund të shkosh për pushime për një kohë më të gjatë - ndërkohë që të ardhurat nuk bien. Në karrierën e ndërtimit të rritjes as kriza nuk ndikon, sepse arritjet e FLP-s u rritën edhe në kohën e vështirësis ekonomike.

Dhe kush solli kthimin tek János Tóth? Seminari i **Miklós Berkics** në Lakitelek.

"Nuk e mbaj si shkallë të lartë, aty ku kam arritur, kam akoma shumë për të mësuar, por tashmë kam përkushtimin dhe entuziazmin" - thotë.

Mundëm të shihnim një video të asave - ose nga roli i bashkpunëtorve më të suksesshëm. Por asët janë të rrallë, prandaj janë të veçantë. "Mua pas tre vjetësh erdhi asi i parë, pastaj brenda gjysëm viti edhe tre të tjerë" - thotë János - mund të vinin edhe më shpejt, por as unë nuk isha ashtu". Këtu senior menaxher-i ja jep fjalën bashkëshortes, sepse siç thonë, "një çift është gjithmonë më shumë se dy vetë". **Annamária Muladi** tregon për jetën cilësore dhe forcën e vetdashjes.

Pas këngëtarit **Norbert L.Király** u klasifikuan menaxher-ët, zotëruesit e + 60 cc dhe Klubi i Sundimtarëve. Dr. Sándor Mílesz thekson: niveli i menaxher-it mund të arrihet tashmë për 2-3 muaj me përparësit e politikës së re të biznesit.





**István Kása dhe Istvánné** që kanë 14 vjet në biznes zunë vendin e parë tek sundimtarët dhe tashmë shumë persona paraqiten që të jenë pjesë e skuadrës së tyre. Na këshillojnë, që të mos friksohemi nga vështirësit, se si të vijne sukseset e para, do të largohen dhimbjet.

Pas shumë efekteve emocionueses do të pasojnë argumentet rationale të **Zoltán Tóth** eagle menaxher. Janë argumentat, krahas asaj që zgjedhim firmë-MLM. Sipërmarrjen që është midis 500 firmave të para në Amerikë. Me origjinë nga familja, pa borxhe, funksionon në 152 shtete me drejtues të shkëlqyer, jep një bazë të sigurt me shumëllojshmërinë e produkteve, dhe një përkrahje të pallogaritshme me shërbimet nga takimet deri tek të mësuarit dhe udhëtimet. "Ju jeni më të mëdhenjtë e gjeneratës së ardhshme!- ju drejtohet Zoltán-i antarëve të rinjë. "Nuk ka nevojë të jesh i përkryer, mjafton, të përgjosh dy-tre tryke dhe të bësh punën tënde. Ky është arti i njehsimit - plusin e jep dëshira për shpërthim."

"Përse nuk jam i suksesshëm?" - kjo është pyetja sipas **Gábor Oláh** senior menaxher, që duhet ti bëjmë vetes, nëse nuk jemi të kënaqur. "Jo rastësit, por rregullshmërit zotërojnë në jetën tënde! Prano përgjegjësin, sepse fati është në dorën tënde.





Kontrollo, që çfarë të lëviz, çfarë të nxit për rezultatet. Sepse suksesi nuk është mundësi, por është çështje vendimi. Gábor thotë, ndryshimi midis interesimit dhe detyrimit është, që e fundit nuk pranon pretekste. "Ta thuash, ta shkruash, ta planifikosh me vetëdije jetën e re" - ky është çelsi.

Beteja me vetveten dhe negativitetin zhvillohet për pikët. Ai që arrin këtu rezultate serioze, ai vlerësohet edhe në podium. Drejtori i përgjithshëm i fton me rradhë sipas pikëve personale të menaxher-it ata që kanë arritur rezultatet më të mira në krijimin e rrjetit dhe pranë tyre assistant supervisorët.

